



09Nr/2022 Rahovec, më datë: 01.08.2022

Për/Za/To:	Sanije Qelaj, Zyrtare e Lartë për Mbrojtjen e Varieteteve të Bimëve dhe Kultura Lavërtare - MBPZHR
CC	z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
Nga/Od/From:	z. Berat Duraku, Drejtor i DBPZHR-së
Subjekti/Predmet/Subject:	Korrje – Shirjet 2022

RAPORTI I SHTABIT KOMUNAL PËR FUSHATËN E KORRJE-SHIRJES 2022

Në komunën e Rahovecit fushata e korrje-shirjes së drithërave ka filluar me datën 29.06.2022 në fshatin **Celinë**, ku ka vazhduar edhe në vendbanime tjera si në Opterushë, Çifllak, Ratkoc, Bratotin, Zaqishtë, Hoçë e Madhe etj. Shtabi komunal për korrje-shirje i formuar nga Kryetari i Komunës, në vazhdimësi është duke e përcjellur punën e fermerëve, në mënyrë që ky proces të përfundoj në kohë reale. Shtabi komunal për korrje-shirje i formuar nga kryetari i komunës, në vazhdimësi ka përcjellur punën e fermerëve, në mënyrë që ky proces të përfundoj në kohë reale. Si në vitet e kaluara edhe në këtë vit aktivitetet rreth fushatës së korrje-shirjeve i kanë vetë fermerët dhe auto-kombajnerët. Grupi kryesisht është dorëzuar në mullirin e M-Sillosit në fshatin Xërxë, në fshatin Çifllak si dhe në pikën grumbulluese në qytetin e Rahovecit. Falë kushteve të mira klimatike fushata e korrje-shirjes këtë vit është zhvilluar me sukses, por ka pasur ndërprerje të fushatës së korrje – shirjes nga rreshjet e fundit atmosferike (moti dhe festa e Kurban Bajramit). Në këtë fushatë janë angazhuar mbi 35 auto-kombanja, ku shumica prej tyre ishin vendor ndërsa pjesa tjetër vinin kryesisht nga qytet fqinjë. Çmimi për korrjen e 1 ha me grurë ishte 130 € deri 180 €, pasi që kjo varej nga zonat e ndryshme ku do të kryhej korrja e grurit dhe marrveshja e lirë në mes të auto – kombanjerëve dhe fermerëve, ku në shumicën e rasteve është paguar 150 €. Sipas të dhënave të marrura nga fermerët, këtë vit rendimenti i grurit do të jetë pak më i ulët për shkak të temperaturave të larta gjatë muajve Prill - Maj që ka ndikuar në zvogëlim të rendimentit. Sipas informatave të deritanishme, fushata e korrje – shirjeve ka përfunduar me sukses, duke mos pasur ndonjë vështirësi të theksuar sa i përket ecuris së korrjeve.



Foto të shkrepura në teren gjatë vizitës së korrje – shirjeve tek fermerët.

Të dhënat për ecurinë e fushatës së korrje shirjeve deri me tani sipas komunave

Komuna	Rahovec
Data e fillimit të korrje-shirjeve	29.06.2022
Numri i autokombajnave	17 vendor Mbi 18 të huaj
Sipërfaqet e korrura me grurë deri me tani (ha)	Rreth 2.000 ha
Sipërfaqet e korrura me elb deri me tani (ha)	4.50 ha – 5 ha
Rendimenti mesatar i grurit (kg/ha)	4.250 kg/ha
Rendimenti mesatar i elbit (kg/ha)	2100 – 2500 kg/ha
Çmimi i korrje shirjeve (€/ha)	130 (€/ha) – 180 (€/ha)
Vështërsit gjatë korrje shirjeve	Ndërpreja e fushatës së korrjeve për shkak të motit të ligë (rreshjet e shiut).

Fermerëve ju urojmë bereqet dhe suksese në punën e tyre të palodhshme.

Anëtarët e shtabit komunal:

1.1 Berat Duraku, kryesues i shtabit

1.2 Ilvi Durguti, zv. kryesues i shtabit

1.3 Veton Mustafa, anëtar

1.4 Hasan Vuçitërna, anëtar

1.5 Milazim Elshani, anëtar

1.6 Nijazi Sokoli, anëtar

1.7 Bekim Krasniqi, anëtar